VENDIM
Nr. 17, datë 7.2.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR INSTRUMENTET E PAGESAVE ELEKTRONIKE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b", nenit 21 dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe të Departamentit të Sistemeve të Pagesave dhe Kontabilitetit e Financës,

VENDOSI:

1. Në nenin 4, pika 1 të rregullores "Për instrumentet e pagesave elektronike", miratuar me vendimin nr. 11, datë 6.2.2008, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar, pas shkronjës "t" shtohet shkronja "u", me përmbajtje si më poshtë:

"Standardet e Industrisë së Kartave për Pagesa (*Payment Card Industry*-PCI) mbi kërkesat e sigurisë së PIN-it janë standardet e krijuara nga Këshilli i Standardeve të Sigurisë i Industrisë së Kartave për Pagesa, me qëllim administrimin, procesimin dhe transmetimin e sigurt të të dhënave të PIN-it.". Këshilli i Standardeve të Sigurisë së Industrisë së Kartave për Pagesa përbëhet nga aktorët kryesorë në industrinë e kartave, me qëllim garantimin e sigurisë dhe efikasitetit në këtë treg.

2. Në nenin 8, pika 4, shkronja "b" ndryshon me përmbajtje si vijon:

"t'i dorëzojë PIN-in në zarf të mbyllur ose me mjete të tjera të komunikimit elektronik, të cilat zbatojnë standardet e PCI-së mbi kërkesat e sigurisë së PIN-it, vetëm mbajtësit dhe askujt tjetër:".

3. Në nenin 19, pika 2, pas togfjalëshit: "PIN-i, i dorëzohet i mbyllur në një zarf" shtohet togfjalëshi: "ose me mjete të tjera të komunikimit elektronik, të cilat zbatojnë standardet e PCI-së mbi kërkesat e sigurisë së PIN-it".

4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe Kontabilitetit e Financës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

5. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e tij në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Sejko